

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e parë të rregullt, e mbajtur më datën 29.01.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.01/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 27.12.2024

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja e nëntë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 27.12.2024.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e nëntë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 27.12.2024.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević





PROCESVERBALI

Nga mbledhja e nentë e rregullt e Kuvendit Komunal të Graçanicës

E mbajtur më datën 27.12.2024 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje janë të pranishëm 17 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 2 asamblistë: Ljubisha Karaxhiq dhe Millosh Todoroviq.

Në mbledhje janë të pranishëm: përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesit e mediave, kryetarja e Komunës së Graçanicës, shefja e Kabinetit, këshilltari i kryetares, drejtorët e drejtorive komunale, Shërbimi për Informim, Shërbimi për Përkthim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit është mbajtur mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri ka dhënë mendim pozitiv për rendin e ditës të propozuar.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 15.11.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën prej 31.05.2024 deri më 30.11.2024, me propozim të kryetares së komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim për vitin 2025, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

5. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Nebojsha Nikolliq.

6. Informata për punën e institucioneve shëndetësore në komunë, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 15.11.2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Ljubisha Karaxhiq, gjithsej 18 asamblistë janë të pranishëm dhe ka kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën prej 31.05.2024 deri më 30.11.2024, me propozim të kryetares së komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Raportin e punës së Komunës së Graçanicës e prezantoj kryetarja e pushtetit lokal, prof.dr. Ljiljana Shubariq, e cila tha se në vitin paraprak, përkundër disa vështirësive, janë arritur rezultate dhe suksese të mira.

Ajo theksoi se janë bërë përpjekje të mëdha për t'i përfunduar të gjitha projektet e planifikuara infrastrukturore dhe se çdo vendi në komunë, çdo qytetari i është kushtuar e njëjta rëndësi dhe është ndihmuar në bazë të nevojave dhe prioritetëve. Siç theksoi ajo, të gjitha drejtoritë dhe shërbimet komunale, përfshirë edhe Kabinetin, kanë punuar me përkushtim, duke u udhëhequr nga qëllimi dhe misioni më i rëndësishëm i qeverisjes lokale, “që është shërbimi dhe ndihma absolute dhe në kohë për qytetarët tanë”.

“Drejtoria Komunale e Buxhetit dhe Financave ka vepruar në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme ndaj çdo shpenzimi, si në buxhet ashtu edhe në punën me palët përmes shërbimeve sportele të arkës. Të hyrat arritën në 1.427.636 euro. Drejtoria Komunale e Inspektionit ka punuar me shumë sukses edhe këtë vit. Rregullimi i tregut ekonomik dhe ruajtja e interesit publik, kontrolllet inspektuese të subjekteve ekonomike, kontrolli dhe pezullimi i punimeve në pronat shoqërore, kontrolli i punimeve ndërtimore, parandalimi i keqpërdorimit të tokës bujqësore, përgjigjja ndaj kërkesave të qytetarëve dhe ruajtja e mjedisit janë disa nga aktivitetet e kësaj drejtorie për të cilat është punuar pa lodhje. Të hyrat totale të Drejtorisë së Inspektionit për periudhën raportuese janë 7.777 euro. Drejtoria Komunale e Arsimit, përveç mbështetjes financiare, ka ofruar edhe mbështetje logjistike për të gjitha institucionet arsimore, qendrat

kulturore dhe klubet sportive në territorin e komunës sonë. Kemi ndërtuar objekte të reja, kemi rinovuar dhe rikonstruktuar ato ekzistuese dhe kemi kryer punime të tjera infrastrukturore që modernizojnë dhe zgjerojnë hapësirën për zhvillimin e procesit mësimor në institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme. Tani do të theksoj vetëm disa: ndërtimin e një objekti ndihmës për ruajtjen e druve të zjarrit në Qendrën e shkollave të mesme në Llapllasellë, rindërtimin e shkollës në Livagjë dhe ndërtimin e kaldajës në Gushtericën e Poshtme dhe blerjen e pajisjeve shkollore. Nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik i kemi mbështetur të gjitha ngjarjet kulturore dhe sportive, kemi investuar më tej jo vetëm në institucionet arsimore, por edhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kemi zbatuar disa projekte që synojnë fuqizimin ekonomik të familjeve, individëve dhe bizneseve të vogla. Vetëm në Qendrën diagnostike në Graçanicë janë ofruar mbi 25 mijë shërbime laboratorike gjatë periudhës raportuese, mbi 7 mijë shërbime në Repartin e fizioterapisë në Graçanicë dhe mbi 5 mijë shërbime në Gushtericën e Poshtme. I kemi modernizuar pothuajse të gjitha shtëpitë lokale të shëndetit, si dhe Qendrën Spitalore Klinike, me pajisje të reja mjekësore”, tha kryetarja Shubariq, e cila më pas i theksoi të arriturat e drejtorive tjera komunale.

“Në fund të këtij viti, duke përmbledhur atë që është bërë, shohim se është e pamohueshme puna e kryer. Në bazë të natyrës dhe fushëveprimit të punës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor është dashur dhe sigurisht ia ka dalë që ta përmbush detyrën e saj vjetore, nga të cilat do ta veçoj: “Rikonstruksionimin, rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në Komunën e Graçanicës”, “Ndërtimin e objektit të banimit social në Llapllasellë – Faza II”, “Renovimin e rrugës “Car Llazar” në Graçanicë - Faza I dhe Faza II”, “Ndërtimin dhe rindërtimin e parqeve në territorin e Komunës së Graçanicës” dhe projektet e tjera. Puna e palodhshme në terren është demonstruar edhe këtë vit nga punëtorët dhe menaxherët e Drejtorisë Komunale të Shërbimeve Publike, të cilët kanë punuar në të gjitha situatat e rregullta dhe emergjente”.

Drejtorja e Kadastrës ka pasur më së shumti punë administrative dhe ka pranuar gjithsej 4106 lëndë në 22 lloje të ndryshme të punëve që kryen.

„Drejtorja jonë e Bujqësisë dhe Pylltarisë vazhdon të jetë e njohur nga qytetarët, sepse si zonë me shumicë rurale, mbetet detyrimi ynë që të kujdesemi për nikoqirët tanë punëtorë, të cilët i kemi ndihmuar në shumë mënyra këtë vit, përmes subvencioneve bujqësore, ndarjes së plehrave, ndërsa në bashkëpunim me Kooperativën Bujqësore kemi shpërndarë pajisje për kultivuesit e frutave dhe fidanët e kumbullës, kemi mundësuar një vizitë në panairin bujqësor në Novi Sad dhe organizuam një sërë aktivitete, ndër të cilat, veçojmë ato që u fokusuan në fuqizimin e gratë në bujqësi”.

“Drejtorja e Rinisë dhe Sporteve, edhe pse nuk ka buxhet të saj, ka arritur rezultate të jashtëzakonshme, falë këtij bashkëpunimi dhe mirëkuptimi, ka organizuar gara të shumta sportive, turne, zgjidhje konceptuale për t'i ndihmuar klubet dhe organizatat sportive, shkollat,

organizimin e fëmijëve për të marrë pjesë në gara. Edhe pse nuk janë pjesë e raportit, Ndërmarrja Publike “Ekologija” dhe Organizata turistike e Graçanicës, e cila gjithashtu nuk është pjesë e këtij raporti, ata kontribuan shumë në punën dhe promovimin e komunës sonë, kanë arritur sukses në punën e tyre gjatë kësaj periudhe raportuese”, tha kryetarja Shubariq, duke folur për punën në gjashtë muajt e fundit të punës.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, kishte një vërejtje se disa projekte të Drejtorisë së Urbanizmit nuk përfunduan këtë vit, edhe pse këtë e kanë kërkuar vazhdimisht asamblistët e Kuvendit të komunës dhe vetë qytetarët. Ajo e përmendi vetëm një projekt që nuk është realizuar prej tre vitesh, që është vendosja e një rampe në Qendrën e shkollave të mesme në Llaplasellë, për t'i bërë fëmijët më të sigurt.

Kryetarja e Komunës së Graçanicës, prof.dr. Ljiljana Shubariq, u përgjigj se është e vetëdijshme që nuk është bërë gjithçka plotësisht, “por duhet të keni parasysh vetë situatën politike dhe të sigurisë dhe shumë gjëra të tjera që po ndodhin dhe që ndikojnë në realizimin e projekteve tona”.

Kryesuesi tha se Komuna e Graçanicës ka realizuar shumë projekte për arsim, nga pajisja e shkollave e deri te projektet jo-infrastrukturore.

Kryetarja e Komunës së Graçanicës, prof.dr. Ljiljana Shubariq, u përgjigj se “shkollat tona janë të pajisura më mirë se çdo shkollë në Serbinë qendrore, falë bashkëpunimit tonë me partnerët ndërkombëtarë, si dhe donacioneve nga Republika e Serbisë”.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 15 asamblistëve “Pro”, 1 votë “Kundër” të Granit Gashit dhe 2 vota “Abstënim” të Sllagjanës Rashiq dhe Sonjës Odallovic, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim për vitin 2025, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, tha se Kuvendi e ka miratuar të njëjtin vendim në dhjetor të vitit 2023.

Asamblisti Bojan Zhivić pyeti se kujt i jepen në shfrytëzim parcelat në fjalë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Aleksandra Gjekiq, u përgjigj se prona e paluajtshme të komunës jepet në shfrytëzim në bazë të thirrjes publike, ndërsa Kuvendi i komunës duhet ta miratojë këtë vendim në mënyrë që të parashikohet dhënia e pronave të paluajtshme të komunës në shfrytëzim vitin e ardhshëm.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2025, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi tha se Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2025 nuk është ndryshuar dhe është identik me Planin e punës për vitin 2024. “Ne nuk i kemi hequr raportet vjetore të komiteteve të tjera sepse mund të ndodhin ndryshime dhe është më mirë të parashikohen, sepse gjatë këtij viti komiteteve tjera u hoqën mëditjet dhe për këtë arsye komitetet nuk i mbajtën mbledhjet. Në shkurt kemi edhe një gabim teknik, ku thotë “Raporti vjetor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik për vitin 2023” kur duhet të jetë për vitin 2024.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Në mbledhje mungon asamblisti Granit Gashi, gjithsej 17 asamblistë janë të pranishëm dhe ka kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Informata për ndarjen e subvencioneve nga fusha e bujqësisë për vitin 2024, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë, Nebojsa Nikolliq.

Kryesuesi tha se drejtori është lajmëruar dhe është në pushim mjekësor.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Informata për punën e institucioneve shëndetësore në komunë, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq.

Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq, u ka ofruar asamblistëve informata për punën e kësaj drejtorie komunale. Ajo theksoi punën e Qendrës diagnostike-laboratorike në Graçanicë, ku numri më i madh i përdoruesve ishte në laborator, ndërsa numri i shërbimeve të fizioterapisë ishte dukshëm më i lartë në krahasim me numrin e përdoruesve. Numri i përgjithshëm i shërbimeve për këtë vit është 5903, ndërsa numri i shërbimeve të ofruara është 61340, më shumë se vitin e kaluar për faktin se kanë pasur subvencione për punësimin e mjekëve specialistë dhe me futjen e analizave të reja, numri i shërbimeve dhe numri i përdoruesve është rritur. Më pas drejtoresha i lexoi projektet kapitale që janë dorëzuar në institucionet shëndetësore përmes planit të prokurimit, duke theksuar blerjen e makinave dhe pajisjeve për dializë.

Kryesuesi e vlerësoi punën e drejtoreshës, duke e pyetur se ku është planifikuar dorëzimi i makinave dhe pajisjeve për dializë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq, është përgjigjur se dorëzimi i apartit dhe pajisjeve për dializë planifikohet të dorëzohet në spitalin e Llapllasellës në kuadër të Klinikës interne.

Asamblistët: Zoran Danilloviq, Vlladica Qurçiq, Sllagjana Rashiq, Ljubisha Karaxhiq dhe Sonja Odalloviq e vlerësuan punën e drejtoreshës Milliq që kur ajo e mori drejtimin e drejtorisë. Ata i ofruan asaj mbështetje për punën e mëtutjeshme në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale në komunën tonë.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, ka pasur një sugjerim për blerjen e CT pajisjes, sepse asamblistja dhe doktoresha kanë pasur të njëjtin sugjerim edhe para 7 vitesh, si dhe për t’iu kushtuar vëmendje maksimale personave me nevoja të veçanta.

Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq, u përgjigj asamblistëve se i viziton personat me nevoja të veçanta në Shtëpinë komunitare për personat me aftësi të kufizuar mendore - pengesa në zhvillimin mendor, të paktën dy herë në javë, ndërsa ata kanë kujdes 24 orë dhe shpërndarje të rregullt të barnave, produkteve ushqimore dhe gjithçkaje që ata kanë nevojë. “Këtë vit ua kemi sjellë teknikën e bardhë, sepse jemi të detyruar t’u ofrojmë të gjitha ato. Ne organizuam gjithashtu një hapësirë për punëtorë në mënyrë që ata të kishin aktivitete dhe argëtim”.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, sugjeroi që ata të pajisen me një mjet që do të ishte në parkingun e tyre dhe në dispozicionin e tyre 24 orë në ditë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq, iu është përgjigjur asamblistëve se aktualisht kanë një veturë, por kanë planifikuar që vitin e ardhshëm të blejnë një veturë të dedikuar për ta.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Të ndryshme.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 10:51.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević